



“I dashur punëtor ndërtimi i huaj,

nëse ndodhesh akoma në Itali ose je kthyer në vendlindje për shkak të situatës së rëndë krijuar nga emergjenca nga Koronavirus, mos harro se Qeveria italiane ka miratuar një numër masash të veçanta për të të garantuar lehtësime, për të ruajtur të ardhurat tuaja dhe vendin e punës, si punonjës e si punëtorë i pavarur.

Përmbledhim këtu masat më të rëndësishme (si dhe ndihmat sociale) në dispozicion:

CIGO (Cassa integrazione ordinaria) me kërkesë për shkak të “Emergjenca Covid-19” për një maksimum prej 9 javësh duke filluar nga 23 shkurt 2020; duhet të bëjnë kërkesë të gjithë firmat me 1 punonjës e sipër (përfshihen edhe kooperativat e artizanët)

Firma duhet të konsultojë, edhe në internet, sindikatat brenda tre ditësh nga aktivizimi i procedurës. Duhet të rezultosh punëtor në fuqi më 23 shkurt dhe nuk është e nevojshme të mbarosh më përpara ditët e lejes së pushimeve.

Ndërmarrjet që me 23 shkurt 2020 kanë mbaruar të gjitha masat e zakonshme në dispozicion, duhet të aplikojnë për **CIGD (Cassa integrazione in Deroga)** për një maksimum prej 9 javësh duke filluar nga 23 shkurt 2020.

Nëse je artizan, punëtor i vetëpunësuar (**Partita Iva**) ose kolaborues (Co.co.co) i regjistruar në “menaxhim të veçantë” (gestione separata) të Institutit kombëtar të sigurimeve shoqërore INPS, është parashikuar për ty një kontribut prej 600 euro për muajin mars, duhet të bësh kërkesë specifike pranë INPS.

Dekreti parashikon edhe leje të jashtëzakonshme **për prindërit** (përfshirë punëtorët e vetëpunësuar) për të dy prindërit nëse alternohen, për fëmijët deri në 12 vjeç ose përndryshe bonus për babysitter, rritjen e lejeve për Ligjin 104 e leje pa pagesë për prindërit e fëmijëve nga 12 deri në 16 vjeç, me detyrimin ruajtjen e vëndit të punës.

MBAJE MEND MIRE se janë të pezulluara të gjithë pushimet nga puna mbas 23 shkurtit, për 60 ditë nga hyrja në fuqi e Dekretit, se pagesa mbetet e njëjta sipas kontratës kolektive (CCNL) e se nuk duhet të të kërkojnë të përdorësh ditët e lejes së pushimeve përveç atyre të vitit të kaluar.

ESHTE E RENDESISHME që para se të largohesh nga Italia të njoftosh punëdhënësin. Nëse ke pyetje o dyshime telefono në zyrat e **FILLEA CGIL** të territorit e ki besim tek ne!

Nëse vazhdon të punosh mos harro të zbatosh rregullat e veçanta shëndetësore të detyrueshme për emergjencën e Koronavirusit, punëdhënësi duhet të të garantojë pajisjet e duhura e të sigurta për mbrojtjen nga virusi!”

Federazione Italiana Lavoratori Legno Edilizia Industrie Affini ed Estrattive

Via G. B. Morgagni, 27 –00161 Roma – Tel. 06 44114625-627-628-637 –FAX 06.44235849

E MAIL: filleanazionale@filleacgil.it - WEBSITE: www.filleacgil.it